

## Historik i 'Lëvizjes VETËVENDOSJE!'

Lëvizja VETËVENDOSJE! është komunitet i njerëzve që refuzojnë të nënshtrohen, dhe synon arritjen dhe realizimin e vetëvendosjes për popullin e Kosovës. Zanafilla e VETËVENDOSJE!-s ndodhet në aktivitetet dhe aksionet e shumta të KAN-it (Rrjeti i Aksionit për Kosovën), që kishin për qëllim të krijojnë një qytetari aktive në Kosovë, të dedikuar në promovimin e vlerave universale në fushat e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe drejtësisë sociale. Themeluar më 1997, nga një grup aktivistësh ndërkombëtarë me në krye shkriktaren amerikane Alice Mead, tash Alice W. James, KAN fillimisht u vu në përkrahje të nismave qytetare kundër okupimit dhe diktaturës së Serbisë në Kosovë, siç është rasti me përkrahjen për Unionin e Pavarur të Studentëve të

Universitetit të Prishtinës (UPSUP) dhe protestat joviolente të tyre për lirin e objekteve dhe hapësirës universitare. Është vazhduar me dokumentimin e krimeve gjatë luftës, ndërsa kulminacionin e vet KAN e ka arritur gjatë viteve 1999 dhe 2000 me fushatën APAL (Albanian Prisoner Advocacy List) për lirin e pengjeve të luftës. Në korrik të vitit 2003, është vendosur që KAN të ketë qendër brenda në Kosovë dhe ta krijojë një rrjet edhe këtu. Që nga kjo kohë, me pjesëmarrje të konsiderueshme të aktivistëve nga gjithë Kosova, KAN ka organizuar një vister aktivitetesh në shërbim të fuqizimit të individëve anekënd Kosovës, dhe krijimit të një shoqërie dinamike dhe reprezentuese.

KAN ka organizuar peticionin në mbështje të zbardhjes së fatit të personave të rrëmbyer në Kosovë, duke mbledhur 236,311 nënshkrime; pastaj padëgjueshmërinë qytetare të familjeve të të pagjeturve (refuzimi i pagesës së tatimeve dhe shërbimeve publike), që ka filluar që nga 31 marsi i vitit të kaluar; po ashtu kemi bllokuar rrugë dhe udhëkryqë; kemi vendosur fotografitë e të pagjeturve në grilat e Kuvendit e Qeverisë së Kosovës; mandej, kemi publikuar nëpër çarçafë – të cilët çdo herë na i vodhi policia – akuzat ndaj personave përgjegjës për vrasjet dhe masakrat në Krushë të Vogël, Gjakovë dhe Reçak; etj.etj. Të gjitha këto janë bërë në bashkëpunim me familjarët e të pagjeturve.

Me 10 qershor 2004, me vërshëllima të pipave, muzikë dhe kartuqa të kuq, në protestën kundër Rezolutës 1244 dhe pikërisht me rastin e 5 vjetorit të saj, mbi 1.000 protestues rreth e rrotull ndërtesës së UNMIK-ut e shpallën veten Qytetarë dhe aktivistë. (Neve në Kosovë konsiderohemi vetëm si banorë, status ky që e gëzon edhe refugjati!) Ata lexuan Deklaratën Qytetare dhe u zotuan se do ta luftojnë regjimin antidemokratik të UNMIKut.

(Kjo protestë paraqet zanafillën konceptuale të asaj që njihet sot si Lëvizja VETËVENDOSJE!) Pastaj është vazhduar me një turne nëpër qytetet e Kosovës duke projektuar sllajde me parulla kundër regjimit jodemokratik të UNMIK-t, në muret e pushtetit si dhe në ato publike.

## 2005

Më vonë, dy herë aktivistët e KAN-it e rrethuan UNMIK-un me shirit të verdhë në të cilin shkruante "Vend Krimi/Mos Kalo".

Aktivitetet tjera përfshijnë kundërshtimin e procesit të decentralizimit në Kosovë, me ç'rast, në Gjilan, Dardanë, Mitrovicë (si vendet më të rrezikuara) dhe në Prishtinë, i kemi djegur shkronjat e punuara prej druri të fjalës decentralizim, për shkak se ky projekt, para se të arrihet shtetësia dhe pavarësia e Kosovës, shpien në ndarje e copëtim të Kosovës.

KAN së bashku me organizatat "Thirrjet e Nënave" nga Gjakova, "26 marsi 1999" nga Krusha e Vogël, dhe me familjarë të Reçakut, më 26 mars, 7 maj dhe 10 qershor 2005 kanë vendosur tre çarçafë me dimensione mbi 20m x 4m në ndërtesat afër UNMIK-ut. Çarçafi i parë ka përmbajtur emrat e 56 personave që akuzohen nga familjarët e viktimave si përgjegjës për vrasjen dhe rrëmbimin e 112 banorëve të fshatit Krushë e Vogël. Çarçafi i dytë ka përmbajtur emrat e 35 personave që akuzohen nga familjarët e viktimave si përgjegjës për vrasjen e 750 banorëve dhe rrëmbimin e 680 të tjerëve që ende janë të pagjetur nga komuna e Gjakovës. Ndërsa, në çarçafin e tretë kanë qenë të shkruar emrat e 20 personave që akuzohen nga

familjarë të viktimave të Reçakut për vrasjen dhe masakrimin e 42 civilëve të fshatit. Angazhimet e KAN-it kanë vazhduar edhe me aktivitete të tjera, siç është rasti me mbështetjen e dhënë organizatës "Thirrjet e Nënave" për realizimin e pjesës së dytë të fushatës "Të gjithëve na mungojnë", ku në dhjetë billborda dhe dhjetë "city-lights" të kryeqytetit janë vendosur emrat e të gjithë personave të pagjetur nga Kosova, pa marrë parasysh përkatësinë etnike, fetare apo tjetërfare.

Më 12 qershor 2005, në muret përreth selisë së UNMIK-ut janë shkruar parullat "JO NEGOCIATA - VETËVENDOSJE!", duke shënuar kështu avansimin definitiv të KAN në Lëvizja VETËVENDOSJE! Aksionet e shkrimit të parullave kanë vazhduar në pothuajse të gjitha qendrat e Kosovës.

Qendrat e VETËVENDOSJE!-s janë themeluar në shumicën dërmuese të komunave të Kosovës. Qëllimi i këtyre është shtrirja sa më e madhe e Lëvizjes sonë, zgjerimi i rrjetit të saj. Në secilën Qendër janë të ndara përgjegjësitë për gazetën dhe radioemisionin tonë, për logjistikën dhe informimin, për rrjetin e Qendrës dhe ndërlidhjet e Qendrës. Përveçqë aksionet tona tash ngjajnë nëpër tërë Kosovën, mundësitë për anëtarësim janë rritur dukshëm. Në secilën Qendër janë themeluar edhe Pikat e VETËVENDOSJE!-s. Një lagje e qytetit ose një fshat themelojnë një pikë të VETËVENDOSJE!-s. Qendra të VETËVENDOSJE!-s janë themeluar edhe jashtë vendit: në Suedi, Norvegji, Danimarkë, Gjermani, Zvicër, Francë, Britani të Madhe dhe SHBA. Aktivistët në këtë të fundit, pra në SHBA, më 24 tetor, përderisa brenda selisë së Kombeve të Bashkuara në Neë York mbahej takimi i Këshillit të Sigurimit ku diskutohej fati i Kosovës, organizuan një protestë në të cilën shprehën kundërshtinë e tyre ndaj negociatave të padrejta dhe për të drejtën e popullit të Kosovës për vetëvendosje. Ata gjithashtu protestuan faktin se në takimin e Këshillit të Sigurimit, fjalën do ta merrte kryeministri i Serbisë, Vojislav Koshtunica, ndërsa Kosova nuk kishte kurrfarë përfaqësimi, ashtu sikur këto gjashtë vitet e fundit. Pikërisht, një nga slloganet e protestës ishte "Jo OKB-ja në Kosovë, por Kosova në OKB!".

Me atë rast, mu para portës së OKB-së, u shpërndanë 2.000 pamflete në njërën anë të të cilave ishte fotografia (tashmë e famshme) e Koshtunicës derisa pozonte me Kalashnikov në dorë, gjatë vizitës trupave serbe në Kosovë në vitin 1998, ndërkaq në anën tjetër të pamfletit u shpallën pikat e VETËVENDOSJES! kundër negociatave të padrejta dhe për të drejtën e Kosovës për vetëvendosje.

Gazeta VETËVENDOSJE! nisi në qershor, fillimisht si gazetë mujore e prej vjeshtës si javore. Ky është numri i 16-të i saj. Zakonisht secili numër ka një temë kryesore të elaboruar në disa shkrime, por edhe rubrikat standarde siç është komenti për tri ngjarjet politike më të rëndësishme të javës dhe Ditari i Lëvizjes. Gazeta jonë shumëzohet në mbi 10.000 kopje dhe shpërndahet anembanë nëpër Kosovë nga aktivistët e VETËVENDOSJE!-s. Po ashtu, ajo del në faqet e mesit të gazetave „Kosova Sot” dhe „Epoka e Re” çdo të martë. Sikurse edhe të gjitha njoftimet e komunikatat e Lëvizjes, edhe gazeta VETËVENDOSJE ! postohet në web faqen - [www.vetevendosje.org](http://www.vetevendosje.org), e cila vetëm brenda muajit nëntor është klikuar 521.369 herë !

Radioemisioni PËRBALLJA përbëhet nga disa rubrika: intervista e shkurtër me një aktivist për ndonjë aktivitet të shquar të lëvizjes VETËVENDOSJE!; debati qendror në të cilin përballen politikanë dhe analistë me aktivistë të Lëvizjes sonë rreth një teme të caktuar; intervistimi i qytetarëve për temën e debatit; dhe, komenti politik i VETËVENDOSJE!-s për ngjarjet më të rëndësishme politike dhe shoqërore në dy javët paraprahe. Ky emision i përdyjavshëm transmetohet ditën e mërkurë në 30 radiostacione lokale anekënd Kosovës. Nëpërmjet radioemisionit PËRBALLJA, i cili ka nisur të emetohet prej qershorit, synojmë të promovojmë debatin jokonformist dhe rëndësinë e organizimit shoqëror e politik të qytetarëve.

Vezët e prishura së pari u hodhën në drejtim të kryetarit të Serbisë, Boris Tadiq, e pastaj edhe kundër Vuk Drashkoviqit, Ministër i Punëve të Jashtme të Unionit Serbi-Mal i Zi dhe kundër Sanda Rashkoviq-Iviqit, udhëheqëse e Qendrës Koordinuese për Kosovë të Qeverisë së Serbisë, të cilat vizituan Kosovën. Aktivistët e VETËVENDOSJE!-s, me rastin e hyrje-daljeve të tyre në selinë e UNMIK-ut në Prishtinë, sulmuan zyrtarët e Serbisë, të shtetit i cili nuk është penduar për krimet e kryera, s'ka kurrfarë keqardhje për humbjet, dëmet dhe vuajtjet që ka shkaktuar, dhe për më tepër do që sërish ta rimarrë Kosovën duke e copëtuar atë paraprakisht përmes decentralizimit. Çdo herë janë hudhur me qindra vezë të prishura (ngase ata s'janë të denjë për vezë të shëndosha sepse në Kosovë 15% të popullatës janë të uritur!) dhe çdo herë shumë aktivistë

arrestoheshin nga njësitë Speciale të SHPK-së. Edhe në të ardhmen, zyrtarët e Serbisë që vijnë në Kosovë, më së paku do të 'mirëpritën' me vezë të prishura.

Deklarata për Dhënien e Pavarësisë Vendeve dhe Popujve të Kolonizuar u shpërnda para ndërtesës së UNMIK-ut me 25 korrik të vitit 2005. Kjo Rezolutë e OKB-së numër 1514, e datës 14 dhjetor 1960, u jep të drejtën për vetëvendosje të gjithë popujve. Ajo iu vendos të gjitha automjeteve të UNMIK-ut, Policisë së UNMIK-ut dhe të SHPK-së tek fshesat e xhamave të përpamë si një gjobë. Aktivistët e VETËVENDOSJE!-s këtë Rezolutë ua shpërndanë edhe ndërkombëtarëve nëpër restorantet e kafiteritë në qendër të qytetit. I njëjti aksion u ndërmor nga të gjitha Qendrat e VETËVENDOSJE!-s nëpër qytetet përkatëse.

Tubimet fillimisht i paraprinin shkrimit të parullave. Në tre muajt e fundit, Lëvizja VETËVENDOSJE! organizon tubime shumë më masive me qytetarë gjithandej nëpër qytetet dhe fshatrat e Kosovës. Në këto tubime, aktivistët e Lëvizjes shpalosin parimet, konceptin dhe vizionin e VETËVENDOSJE!-s, për të vazhduar me argumentet kundër decentralizimit dhe negociatave me Serbinë. Prezentimi gjithnjë pasohet me debat të hapur me qytetarë dhe me anëtarësimin e shumë prej tyre më pastaj. Tubime të tilla janë mbajtur edhe me studentë nëpër fakultetet e Universitetit të Prishtinës.

Gjaku i shkelur ndodhi para Kuvendit të Kosovës me 29 shtator. Në të tri hyrjet e këtij institucioni aktivistët e Lëvizjes VETËVENDOSJE! derdhën ngjyrë të kuqe. Deputetët që hynin në Kuvend kalonin mbi të, me këpucët e tyre të lustruara ose me xhipat e blinduar. Gatishmëria e këtyre njerëzve për ta negociuar lirinë është e padrejtë, sepse nënkupton shkeljen mbi gjakun e derdhur përgjatë sakrificave të bëra për çlirim. Dy muaj më vonë, Lëvizja VETËVENDOSJE! realizoi aksion përderisa përfaqësuesi special i negociatave të Kosovës me Serbinë, Marti Ahtisaari, takoi anëtarët e Grupit të Unitetit, në rezidencën presidenciale. Në rrugën që çon kah ky vend, ndodhej shiriti i verdhë në të cilin shkruante: VEND KRIMI - MOS KALO dhe përtej tij me ngjyrë të bardhë ishte vizatuar harta e Kosovës, kurse ngjyrë e kuqe që simbolizonte gjakun ishte derdhur përreth saj. Xhipat dhe veturat e zyrtarëve të pushtetit të padrejtë të UNMIK-ut dhe IPVQ-ve shkelën mbi ngjyrë. Nëse 4-5 liderë janë të gatshëm të pranojnë zgjidhje të dëmshme, këtë gjë s'duhet ta lejojnë 2 milionë njerëz.

Kundër decentralizimit janë ndërmarrur shumë aktivitete nëpër Kosovë e posaçërisht në Prishtinë, Gjiilan, Dardanë dhe Mitrovicë. (Në Prishtinë policia nuk arriti të arrestojë aktivistët për shkak të numrit të madh të tyre.) Është filluar me djegien e shkronjave të punuara prej druri të fjalës DECENTRALIZIM dhe paraqitjen e pasojave të decentralizimit në një hartë të madhe, e deri te peticioni në Cernicë. Kjo e fundit paraqet një ndër aksionet më të vlefshme të Lëvizjes sonë. Nëpërmjet decentralizimit po bëhen përpjekje që të zgjerohen enklavat, të lidhen ato territorialisht dhe të legalizohen strukturat e Serbisë atje, drejt krijimit të entitetit serb brenda Kosovës. Konkretisht, duan që Cernicën me 2685 banorë shqiptarë dhe 600 serbë t'ia bashkëngjesin Parteshit me 1434 banorë serbë dhe Budrigës së Poshtme me 1250 serbë, në mënyrë që Parteshi të bëhet komunë. Shqiptarët do të përbënin 45% ndërsa serbët 55% të komunës së Parteshit. Njëherazi, shqiptarët do të gjenden në territoret e kontrolluara drejtpërdrejt nga strukturat militare shtetërore të Serbisë, ndërsa që toleruara nga UNMIK-u. Ky proces është i patolerueshëm. Jorastësisht atë e kundërshtoi vetë popullata e Cernicës. Për këtë punë u organizua peticion. Cernica ka 2350 banorë me të drejtë vote. Janë mbledhur 1294 nënshkrime të banorëve të fshatit Cernicë kundër decentralizimit. Ata refuzuan që fshati i tyre t'ia bashkëngjitet dy fshatrave serbe, në një kohë kur Kosovës i mungon sovraniteti dhe mekanizmat shtetërorë për mbrojtjen e integritetit territorial të vendit. Me këtë peticion është treguar se populli është ai që duhet të vendosë për vete, e jo të tjerët për të. Ky vullnet i qytetarëve, pastaj ka shërbyer si bazë e strategjisë legjitime të kundërshtimit të decentralizimit me të gjitha format. Cernica është hequr nga plani që të jetë pjesë e Parteshit në pakon e Ahtisaarit. Kosovës duhet t'i hiqet decentralizimi. Kosovës nuk i duhet decentralizimi. Asaj i duhet vetëvendosja.

FUND u shkrua nëpër xhipat e administratës së UNMIK-ut me shenjën UN me 20 tetor të këtij viti. Aktivistët shtuan nga dy shkronja: shkronjën F përpara shenjës UN dhe shkronjën D pas. Aksioni nënkuptonte dhënien FUND këtij regjimi shtypës. 36 aktivistë u arrestuan me atë rast. Regjimi i UNMIK-ut në shpërputhje me vullnetin e popullit është mohim i lirisë. Sistemi jeton si shtypës. Populli shtypet. Prandaj, këtij regjimi i duhet një FUND. Askush tjetër s'do t'ia sillte atë më mirë se vetë populli. Kjo është arsyeja pse porosia dhe qëllimi ynë ndaj strukturave antidemokratike të UNMIK-ut u shkrua nëpër xhipat e

tyre. UNMIK-u ka veç xhipa, ngase Kosovën e percepton herë si xhungël e here si shkretëtirë. Në fakt, ata edhe po e shndërrojnë Kosovën në këtë paragjykim të tyre. Po ky aksion, më pas, u ndërmor edhe në Prizren, Gjilan e Ferizaj.

Nekrolog për UNMIK-un së pari përpiloi Qendra e VETËVENDOSJE!-s në Prizren, e më pastaj ai u shpërnda dhe u vendos nëpër të gjitha qytetet e Kosovës. Policia çdo here intervenoi duke i shqyer këto nekrologje. Një regjim, pushteti i të cilit nuk buron nga vetë populli, një sistem që është në kundërshtim me vullnetin dhe interesat e qytetarëve, mbi të cilët ai qeveris padrejtësisht, nuk mund të ketë fat tjetër përveç vdekjes. Sepse FUND-i i jetës së tij është lindja e popullit, fillimi i lirisë së domosdoshme. Askush tjetër nuk do ta bëjë këtë gjë më mirë se vetë populli. Liria kolektive e ka emrin vetëvendosje.

198 arrestime gjithsej janë bërë ndaj aktivistëve të VETËVENDOSJE!-s dhe qytetarëve që iu bashkuan atyre prej 12 qershorit të vitit 2005 e deri më sot. 16 aktivistë janë arrestuar atëherë kur kemi hedhur vezë në drejtim të Vuk Drashkoviçit, ndërsa të tjerët janë arrestuar duke shkruar parullën "JO NEGOCIATA - VETËVENDOSJE!" gjithandej nëpër Kosovë. Jemi arrestuar në Prishtinë, Mitrovicë, Gjilan, Ferizaj, Lypjan, Shtime, Prizren, Besianë dhe Therandë. SHPK-ja nuk na ka arrestuar dhe nuk na ka penguar në Skënderaj, Burim dhe Malishevë. Për shumicën dërmuese të këtyre arrestimeve vazhdojnë procedurat e Gjykatave ndaj nesh. Po ashtu vazhdon edhe procedura e lëvizjes sonë kundër këtij pushteti jodemokratik dhe për vetëvendosje. Në Ferizaj gjykatësi për kundërvajtje, 7 aktivistëve ua ka shqiptuar dënimin prej 150 eurove secilit ose 10 ditë burg. Aktivistët e VETËVENDOSJE!-s nuk paguajnë dënimin. Ne s'jemi dhe nuk ndjehemi fajtorë. Në Shtime dhe Prizren policia i ka rrahur aktivistët edhe pas arrestimit dhe madje gjersa ata i kishin duart të lidhura. Policia bëhej gjithnjë e më e dhunshme, gjithnjë e më brutale. Sistemi tashmë nuk po vepron vetëm nëpërmjet SHPK-së, por edhe përmes njësive speciale si dhe eprorëve të UNMIK-ut. Në Prizren madje ishin edhe ushtarët e KFOR-it. Në Shtime, Besianë dhe Therandë policia ka përdorur sprejin i cili shkakton djegie në lëkurë dhe pamundëson shqisën e të pamurit për dy orë. Në Pejë janë dënuar 5 aktivistë me 160 ditë burg gjithsej, ndërsa dy të tjerë në Mitrovicë me 200 përkatësisht 300 euro. Neve na akuzonin për prishje të rendit e qetësisë publike, mirëpo neve gjithkund të gjithë qytetarët na ndihmonin në aktivitete dhe nuk ankoheshin. Në fakt, ia prishnim dhe po ia prishim qetësinë pushtetit të UNMIK-ut në shërbim të të cilit shumë zellshëm është vënë policia. Na akuzonin për dëmtim të pronës private aty ku i shkruajmë parullat, mirëpo neve vetë qytetarët na ftonin që në muret e shtëpive dhe lokaleve të tyre t'u shkruajmë parullën tonë. Në Kosovë policia nuk zbaton ligjin por urdhërat e UNMIK-ut. UNMIK-u thotë atë që është: JO VETËVENDOSJE. Koncepti i 'standardeve para statusit' thotë: NEGOCIATA. Prandaj parulla jonë godet sistemin dhe procesin aktual politik, i cili po e shpien Kosovën drejt robërisë nën Serbi.

## 2006

'12:44 time's up - UNMIK go home'. Më 7 janar, me shkruarjen e parullës '12:44 time's up – UNMIK go home' në xhipat e UNMIK-ut bëmë të ditur që UNMIK-u si regjim antidemokratik po shkel vullnetin e popullit të Kosovës dhe është i padëshirueshëm në vendin tonë.

FUND. Me 11 janar 2006 në Viti, aktivistët e kësaj qendre shkruajtën në xhipat e UNMIK-ut parullën FUND. Fundi i këtij regjimi do të ishte fillimi i një kapitulli të ndritur të historisë sonë.

Dënohet UNMIK-u. Dënohet UNMIK-u që është parkuar në vendin e gabuar – në Kosovë. Ai as që është dashur të vijë, por tani që është këtu qëndron pa treguar kur do të shkojë. UNMIK-u po ja mohon popullit lirinë duke e çuar në mjerim shoqëror e ekonomik. Në bashkëpunim me armikun tonë, Serbinë, po na ngulfasin me decentralizim e 'eksterritorialitet'. Prandaj ne Lëvizja VETËVENDOSJE! si dënim minimal për krejt këto i shfryjtëm gomat e xhipave të tyre. Populli merr frymë vetëm atëherë kur ky sistem i padrejtë vdes.

Kërkohet banda e vrasjes dhe plaçkitjes së Kosovës. Anëmbanë Kosovës u vendos posterit me fytyrat më të kërkuara të atyre që po e plaçkisin vendin tonë. Ata kanë pranuar të bëjnë pazar me vullnetin e 2 milionë njerëzve të Kosovës, pa e pyetur asnjërin prej tyre. Do të ulen në tryezë të rrumbullakët me përfaqësuesit e shtetit që ka kryer gjenocid në Kosovë, e i cili jo vetëm që nuk është dënuar për këtë gjë, por as që po ndjehet përgjegjës. Kjo bandë po shkon në Vjenë për ta decentralizuar Kosovën.

Decentralizimi=>Ndarje, Ndarja=>Luftë. Ditën kur kryenegociatori Marti Ahtisari vizitoi Kosovën, më 1 mars, aktivistët e Lëvizjes VETËVENDOSJE! përpara selisë qendrore të UNMIK-ut vendosën çarçafin në të cilin ishte e vizatuar harta e Kosovës dhe kufijtë e brendshëm në vendin tonë që i krijon procesi i decentralizimit. Decentralizimi, emërtim ky prapa së cilit fshihen aspiratat hegjemoniste dhe ekspansioniste të Serbisë dhe karakteri shovinist i pushtetit të saj, pasi që u sajua në Beograd iu imponua UNMIK-ut dhe ky i fundit ia imponoi IPVQ-ve të Kosovës edhe ashtu servile.

Vaksinimi kundër virusit U1N2M4I4K. Më 26 mars filloi fushata e vaksinimit të qytetarëve të Kosovës. Qëllimi i këtij vaksinimi ishte imunizimi i popullatës kundër këtij virusi i cili shkakton sëmundjen unmikitis.

Protestë në Deçan kundër vendimit ekzekutiv 2005/5. Sipas këtij vendimi, 800 hektarëve tokë përreth Manastirit të Deçanit u është dhënë status i veçantë, Afër 600 hektarë të kësaj hapësire janë prona të bujqve shqiptarë. Demonstrata zgjati dy ditë, më 13 dhe 14 prill, kur aktivistët të Lëvizjes dhe qytetarë nga Deçani bllokuan ndërtesën e UNMIK-ut në qytezë.

Sanë për Petersenin. I vetmi aktivitet që u lejohet fshatarëve në pronat e tyre të uzurpuara prej manastirit është kositja e barit. Prandaj më 24 Prill 2006 aktivistët e Lëvizjes VETËVENDOSJE! e shkarkuan para UNMIK-ut një traktor me këtë bar të kositur, bar të cilin fshatarët ia dërguan Soren Jessen-Petersenit, kryeadministrator i atëhershëm i UNMIK-ut dhe nënshkrues i vendimit famëq, meqë atyre nuk po iu nevojitet asgjë. Të gjithë sanën që i teproi ai ia dha Veton Surroit.

'Evakuimi'. Përderisa nga ndërtesa përballë, hedheshin mijëra letra që përmbanin 'Dhjetë Urdhërat e Evakuimit', një tekst ky parodizues se si personeli i UNMIK-ut duhet të evakohet, ndërkohë në prapavijë dëgjohej sirena e fuqishme alarmuese e cila i ftonte zyrtarët e UNMIK-ut që ta lëshojnë ndërtesën menjëherë.

Fushata kundër produkteve të Serbisë. Kosova mund të jetojë pa Serbinë. Kosova do ta ketë jetën shumë më të mirë pa Serbinë. Prandaj ne duhet të jetojmë pa produktet e Serbisë.

50 JAVË>>>ORGANIZIM-BALLAFAQIM. Në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë, u hap ekspozita e Lëvizjes VETËVENDOSJE! Në 258 fotografi të renditura kronologjikisht janë paraqitur aksionet e ndryshme dhe tubimet publike me qytetarë të Lëvizjes VETËVENDOSJE! të realizuara anekënd Kosovës, por edhe pamje nga intervenimet brutale të policisë kundër aktivistëve. Po kjo ekspozitë, më pas, u hap edhe në qytete tjera si në: Gjilan, Ferizaj, Prizren, Skënderaj, Lypjan etj.

Demonstratë gjithëpopullore përpara selisë qendrore të UNMIK-ut në Prishtinë. Mijëra qytetarë të Kosovës iu bashkuan Lëvizjes VETËVENDOSJE! në bllokimin e punës institucionale të UNMIK-ut. Kjo u bë më 8 dhe 9 qershor të vitit 2006, një ditë para vazhimit automatik të mandatit të Rezolutës 1244, dhe sovranitetit të Serbisë mbi Kosovë që garantohet me këtë Rezolutë. Ndaj këtij bllokimi intervenuan njësitet special të SHPK-së të cilat dhunshëm ia hapën hyrje daljet UNMIK-ut, dhe me të zbatimit të sovranitetit të Serbisë. 80 aktivistë u arrestuan me këtë rast të cilët u dënuan me nga 10 ditë burg, të cilin të vuajtën të gjithë.

Përsëritja e Milosheviqit. Koshtunica dhe zyrtarët tjerë serb ia mësynë Kosovës, për t'i shpërfaqur planet e tyre hegjemoniste dhe koloniale ndaj Kosovës. Kjo u bë në ditën kur shënohet Beteja e Kosovës. Aktivistët e Lëvizjes VETËVENDOSJE! i bllokuan rrugët të cilat dërgojnë në kufi me Serbinë, me ç'rast intervenuan njësitet speciale të SHPK – së, për t'ia hapur rrugët të të pa dëshiruarve nga Serbia.

Demonstratë gjithëpopullore më 24 korrik së bashku me ODL të UÇK-së, LPK-në, LKÇK-në, Thirrjet e Nënave, 26 Marsi 1999 e IQLL. Këtë ditë Ekipi i Unitetit kishte takohet në Vjenë me delegacionin e Serbisë, ku negociohej vullneti politik i popullit të Kosovës për të mos u realizuar ai.

Buletini javor në gjuhën angleze. Më 23 qershor Lëvizja VETËVENDOSJE! Publikoi numrin e parë të buletinit javor në gjuhën angleze për t'ia sqaruar publikut jo shqipfolës konceptin dhe aktivitetet tona politike.

Kundër Ahtisaarit. U bllokuan hyrje-daljet e Asamblesë së Kosovës ku mbahej takimi i Marti Ahtisaarit me Grupin Negociator të Kosovës. Ne synuam parandalimin e takimit qëllimi i të cilit ishte zgjerimi i territoreve të kontrolluara prej Serbisë brenda Kosovës.

Demonstratë kundër decentralizimit në Viti dhe Gjilan. Më 1 dhe 9 shtator organizuam demonstratë kundër projektit të decentralizimit i cili po e copëton Kosovën për t'ia përmbushur apetitet territoriale armikut tonë hegjemonist Serbisë. Demonstratës iu bashkuan të gjitha degët e partive politike në këto komuna të Kosovës, për shkak se këto dy komuna janë ato që më së shumti e pësojnë nga decentralizimi.

M... i radhës. Aksion kundër UNMIK-ut si garantues dhe sigures i referendumit të Serbisë në Kosovë. Aktivistët vendosën para selisë qendrore të UNMIK-ut një guaskë toaleti sa për të simbolizuar veprimin e tij jashtëqitës të radhës në përkrahje të sovranitetit të Serbisë mbi Kosovën. Përveç kësaj ndërtesa e UNMIK-ut u përlye me ngjyrë.

Bllokohet Ruckeri në Prizren. Dhjetëra aktivistë të Lëvizjes VETËVENDOSJE! Bllokuan hyrje-daljet e Kuvendit Komunal të Prizrenit në kohën kur atë po e vizitonte udhëheqësi i UNMIK-ut, Joachim Ruecker. Vizitat e kryeadministratorit anekënd Kosovës po bëhen për t'i bindur udhëheqësitë komunale për implementimin e procesit të rrezikshëm e të dëmshëm të decentralizimit i cili e copëton vendit tonë.

U skuqën IPVQ-të dhe UNMIK-u. Dhjetëra mijëra shqiptarë nga Kosova, Maqedonia dhe Shqipëria festuan duke demonstruar kundër ndarjes së Kosovës dhe katandisjes së saj në një robëri të re. U zgjodh 28 Nëntori për shkak se tash, kur po na përgatitet robëria e re dhe varësia e re nga Serbia, nuk kemi fare arsye për të festuar, dhe energjinë e kanalizuar në demonstratë kundër kthimit nën Serbi.

Tubimet me qytetarë. Gjatë këtij viti u organizuan 68 tubime dhe debate me qytetarë në qytete dhe fshatra të Kosovës. Shumica e tubimeve janë mbajtur në qytetet dhe fshatrat të cilat janë të rrezikuara nga procesi i decentralizimit, 'eksterritorialitetit' dhe rikolonizimit të Kosovës. Shumë tubime janë mbajtur me studentët në konvikte si dhe në amfiteatro të fakulteteve të ndryshme.

Arrestimet dhe dënimet. Gjatë këtij viti u arrestuan 322 aktivistë. Prej tyre 110 u dënuan me vuajtje dënimi me burg. 81 aktivistë u dënuan me 10 ditë burg, 12 aktivistë u dënuan me nga 20 ditë burg si dhe 17 aktivistë u dënuan me nga 30 ditë arrest shtëpiak. Kohëve të fundit u riaktualizuan edhe shumë lëndë nëpër gjykata për arrestimet e mëhershme të aktivistëve. Gjithashtu është shtuar edhe presioni psikologjik ndaj familjeve të aktivistëve të Lëvizjes. Edhe gjatë këtyre ditëve shumë aktivistë janë duke u kërkuar nëpër shtëpitë e tyre.

## 2007

Prezentimi i pakos së Ahtisaarit nëpër qytetet e Kosovës me qëllim të vetëdijësimit të qytetarëve për dëmin që i sjell Kosovës kjo pako. Ky prezentim është bërë perms paraqitjes vizuele të proceseve të përfshira në pako.

Demonstrat e 10 shkurtit. Dhjetëra mijëra qytetarë të Kosovës iu përgjigjën ftesës së Lëvizjes VETËVENDOSJE! për ta demonstruar vendosmërinë tonë në kundërshtim të pakos së Ahtisaarit dhe ndarjes territoriale, fetare dhe institucionale të Kosovës që e bën kjo pako, vetëm e vetëm për ta mbajtur Kosovën si pjesë të Serbisë. Policia i bllokoi rrugët ku marshonin demonstruesit paqësor dhe intervenoi dhunshëm kur demobstruesit deshën të kalojnë për ta vazhduar marshin e tyre. Arben Xheladini dhe Mon Balaj u vranë, ndërsa 82 demonstrues të tjerë u plagosën, disa rëndë, nga plumbat e gomës që i përdori policia. 15 demonstrues u arrestuan.

Homazhe për Arben Xheladinin dhe Man Balajn. Më 11 shkurt aktivistë të Lëvizjes dhe qytetarë të Prishtinës u mblodhën në vendin ku kishin rënë dëshmorët Arben Xheladini dhe Mon Balaj për të bërë homazhe.

Demonstrata e 3 Marsit. Demonstratës gjithëpopullore iu bashkuan dhjetëra mijëra qytetarë të cilët shprehën mllefin kundër pushtetit që robëron dhe vret. Policia e kishte bllokuar një pjesë të marshutës së demonstratës, por pas ultimatumit nga Lëvizja VETËVENDOSJE! ata u detyruan ta hapin rrugën. Para selisë së policisë në Prishtinë u vendos mbishkrimi VRASËS në të gjitha gjuhët e ekipeve policore që morën pjesë në intervernimin e 10 shkurtit.

Ekspozita e Pakos së Ahtisaarit. Aktivistë të Lëvizjes VETËVENDOSJE! gjatë tërë javës kanë ekspozuar nenet nga Pakoja e Ahtisaarit të cilët ngërthejnë në vete padrejtësitë e tmerrshme të këtij dokumenti, i cili do t'ia shkatërrojë Kosovës të ardhmen. Këto nene nga të gjitha anekset e pakos shpjegojnë në detaje pengesat që do t'i ketë Kosova në të ardhmen, pengesa këto që kanë të bëjnë me funksionimin e politikës, ekonomisë dhe shoqërisë së Kosovës në përgjithësi.

Demonstratë me 31 Mars. Në këtë demonstratë u kërkua vetëvendosja si lirim nga burgu kolektiv i popullit të Kosovës, dhe lirimi i të gjithë të burgosurëve politik individual në Kosovë.

Rrencat. Më 1 prill qytetarët e Prishtinës i kanë votuar rrencat më të mëdhenjë ndër politikan. Procesi i votimit është mbajtur sot në Prishtinë, dhe është organizuar nga Lëvizja VETËVENDOSJE! Në të kanë marrë pjesë 974 qytetarë të Prishtinës. Fitues doli Hashim Thaçi me gjithsej 418 vota, pra gati gjysma e votuesve e shpallën atë rrencin më të madh.

1989. Më 5 prill 2007 deputetët e Kuvendit të Kosovës janë mbledhur në të njëjtën sallë për ta miratuar me aklamacion një deklaratë mbështetëse për Pakon e Ahtisaarit. Me këtë Pako na është thënë se Kosova fiton çdo gjë. Njëjtë si më 1989.

“Lirojeni Albinin.” Shkrimi i parullës “Lirojeni Albinin!” dhe “Free Albin!” në murin e UNMIK-ut. Kjo parullë është shkruar edhe në qendrat tjera të Kosovës.

VRASËS. Në makinat e UNMIK-ut është shkruar parulla VRASËS. Kjo parullë ua ka përkujtuar qytetarëve të Kosovës shndërrimin e regjimit colonial në edhe regjim terroristë pas 10 shkurtit.

Tryezë. Lëvizja VETËVENDOSJE! në bashkëpunim me Këshillin e Studentëve të Fakultetit Juridik të UP-së organizoi tryezën e rrumbullakët “Pakojë e padrejtësisë dhe mosfunksionalitetit” me intelektualë. Aty u analizuan dëmet e pakos së Ahtisaarit në 3 rrafshë: atë juridiko/politik, rrafshin ekonomik dhe të sigurisë.

Tryezë dhe protestë në Pejë. Më 19 maj 2007, në Pejë u mbajt tryeza e rrumbullakët, e organizuar nga Lëvizja VETËVENDOSJE! me temën Pakoja e Ahtisaarit – uzurpuesë e trashëgimisë sonë. Në këtë tryezë ku morën pjesë intelektualë nga Peja si dhe përfaqësuesit e disa partive politike, përfshirë përfaqësuesit e Kuvendit Komunal të Pejës, u diskutua muri i cili ndërtohej në atë kohë përreth Patrikanës së Pejës. Pas tryezës aktivistë të Lëvizjes dhe qytetarë të Pejës organizuan protestë në hyrje të Patrikanës.

Tryezë në Drenas. Me 7 qershor Lëvizja VETËVENDOSJE ! organizoi tryezë në Drenas me temën Pakoja e padrejtësisë dhe jofunksionalitetit.

Dy vjetori. Me rastin e dy vjetorit të themelimit të Lëvizjes VETËVENDOSJE! u mbajt një ekspozitë ku janë përmbledhur fotografitë më të mira nga të gjitha aksionet, tubimet dhe demonstratat e organizuara gjatë këtyre dy viteve.

Pakojë e plehut. Në qershor Lëvizja VETËVENDOSJE! ka organizuar aksionin e shkrimit të parullës “Pakojë e Ahtisaarit” nëpër kontenierat e plehut në Prishtinë. Kjo ka simbolizuar pakon si një kontenjerë që përmban shumë gjësende, të gjitha këto me vlerë plehu për të ardhmen e Kosovës. Ky aksion është realizuar edhe në qendrat tjera të Kosovës.

Memorandum. Lëvizja VETËVENDOSJE! ua ka dërguar dy memorandume një numri të organizatave ndërkombëtare që merren me të drejtat e njeriut. Memorandumi argumenton se si janë shkelur të drejtat e njeriut me mbajtjen e vazhdueshme të aktivistëve tonë në paraburgim.

Tryezë në Besianë. Më 27 qershor, në Besianë u mbajt tryeza e rrumbullakët e organizuar nga Qendra e Lëvizjes VETËVENDOSJE! atje.

6 mujori i 10 shkurtit. Me 10 gusht 2007 me rastin e 6 mujorit të demonstratës së 10 shkurtit dhe rënies së Arbenit dhe Monit Lëvizja ka organizuar homazhe te vendi ku u qëlluan dy dësborët. Pastaj kemi vazhduar drejt zyres së Britanisë së Madhe ku ia dërguam një letër publike shefit të zyres, David Blunt, me pyetjen – “Ku ndodhet Steven Curtis?”. Në fund shkuam tek zyra e Rumanisë të cilën e goditëm me vezë të prishura. Ky shtet po i mbanë kriminelët që vranë Arbenin dhe Monin.

Manipulimi i UNMIK-ut. Me 11 shtator në murin e UNMIK-ut kemi filluar me shkruarjen e parullës UNMIK-u manipulon fëmijët! Në këtë mur, ku zakonisht i shkruanim parullat tona liridashëse, UNMIK-u i ka angazhuar disa fëmijë për të vizatuar pikturat e veta aty. Në disa vende fëmijët kanë shkruar “E duam UNMIK-un”, shpërfaqje kjo e qartë e qyqarllëkut të këtij pushteti shtypës i cili po i manipulon fëmijët për ta mbrojtur veten dhe padrejtësinë e tij.

Promovimi i librit. Institutit Albanologjik tw Prishtinës do të bëhet promovimi i librit "ZGJOHU - Për rezistencë drejtë lirisë" i Albin Kurtit. Fjalët e rastit mbajtën Sadri Fetiu, Muhamet Mavraj dhe Glauk Konjufca.

Gjatë këtij viti janë arrestuar 84 aktivistë. Janë lënduar 84 aktivistë dhe qytetarë, si dhe janë rrahur 9 aktivistë

Sot, Lëvizja VETËVENDOSJE! ka shtrirë veprimtarinë e saj në shumë qendra dhe vendbanime të Kosovës, numëron qindra aktivistë, mijëra mbështetës, gjithnjë në përpjekje për të mobilizuar dhe organizuar popullin e Kosovës në misionin e arritjes dhe realizimit të së drejtës për vetëvendosje. Të përkushtuar dhe të angazhuar maksimalisht. Deri në vetëvendosje për popullin e Kosovës.